



USAID
NGA POPULLI AMERIKAN

**PROGRAMI I QEVERISJES
VENDORE NË SHQIPËRI**

Histori Suksesi

Partneriteti Privat-Publik Eshtë Celësi për Përmirësimin e Pastërtisë në Qytetin e Gramshit

Qytetarët dhe partnerët e biznesit punojnë me bashkinë e Gramshit për të mbajtur komunitetin e tyre të sigurt, të pastër dhe te bukur.



Vullnetarët e komunitetit duke vendosur stola te rinj gjatë Ditës së Pastrimit të qytetit të Gramshit.

Një qëllim kryesor i punës së LGPA-së është të ndihmojë bashkitë të përmirësojnë shërbimet publike, të angazhojnë qytetarët, dhe aktorë të tjerë për të punuar me institucionet e qeverisjes vendore në këtë përpjekje. Në qytetin e Gramshit, programi LGPA ka synuar në përmirësimin e shërbimit të pastrimit (mbledhjen/hedhjen e mbeturinave).

Për vite, qyteti i Gramshit ka patur probleme përsa i takon pastërtisë, dhe gjithashtu kombinimi i tyre i ka vështirësuar deri tani përpjekjet e bashkisë. Bashkia vendosi që shumë probleme përfshirë mungesën e kazaneve dhe koshave të vegjël të mbeturinave, cilësinë e ulët të shërbimit të pastrimit si rezultat i mungesës së fondeve dhe disipline së ulët të një pjese të qytetareve në hedhjen e mbeturinave kërkonin përpjekje të mëdha dhe kreative të mënyrës se si qyteti duhet mbajtur pastër.

Në mënyre që reformat ne parashikimin e shërbimeve te jenë të qëndrueshme, bashkia vendosi të angazhoj me shumë qytetarët si dhe biznesin privat në krijimin e planit të përmirësimit te shërbimeve. Me mbështetjen e Programit të USAID-it për Qeverisjen Vendore në Shqipëri (LGPA), bashkia zhvilloi një rishikim financiar dhe operacional te gjerë të Organizimit të Pastrimit të qytetit. Bazuar në vlerësimin për të mbajtur qytetin e pastër, janë perlllogaritur tarifave për mbulimin e plotë të kostove duke përfshirë dhe nevojat për investime kapitale.

Për të siguruar mbështetjen e komunitetit për rritjen e tarifave të propozuara një komitet me përfaqësues të komunitetit është përfshirë në rishikimin e vlerësimeve si dhe për të votuar opsione të ndryshme të cilat balancojnë rritjen e tarifave me përmirësimet ne shërbime. Ky komitet votoi të rriten tarifave me 50% dhe një vendim i këshillit bashkiak në mënyrë unanime vendosi në një rritje prej 25%.

Ky nuk ishte i vetmi hap i ndërmarrë nga Bashkia për të siguruar përfshirjen e komunitetit. Me sloganin “*Ne, Qytetarët e Gramshit, Angazhohemi Sot për Një Qytet më të Pastër Nesër*”, shumë qytetarë, organizata të shoqërisë civile, biznese, dhe student, në mënyrë vullnetare iu bashkuan bashkisë në një përpjekje për pastrimin e qytetit në 5 Mars 2010 për të iniciuar planin e ri të veprimit për përmirësimin e shërbimeve në qytet.

Partneritetet u krijuan me biznesin privat, grupet e komunitetit dhe shkollat. Nxënësit e shkolles së mesme pastruan rrugën kryesore, mjediset e shkollës dhe parqet. Vullnetarët e Korpusit të Paqes dhe të komunitetit vendosën stola të rinj dhe rregulluan mbi 100 metra rrugë këmbësorësh në tre parqe publike. Janë vendosur dyzet kazanë të mëdhenj mbeturinash, 120 stola parku, 100 kosha me të vegjël mbeturinash, si dhe lule, kontribute këto të komunitetit, biznesit dhe USAID-it. Gjithashtu Zyra e Mbrojtjes e Ambasades Amerikane kontribuoi me \$120,000 për të riparuar pajisjet e jashtme rikrijuese te shkolles se mesme te qytetit.

“Ishte hera e parë që unë kam parë kaq shumë aktorë të qytetit tim të përfshirë në një aktivitet të madh.” thotë Z.. Ymer Kumria, inspektor kontrolli në drejtorinë e shërbimeve të bashkisë. “Kjo gjë më beri me shpresë. Në atë moment, unë e kuptova që me pak përpjekje dhe dëshirë të mirë të bashkisë, biznesit dhe shoqërisë civile, ne mund të kemi një qytet te pastër. Gjatë kontrolleve qe une kryej shpesh, vë re që rrugët jane në mënyre të vazhdueshme më të pastra dhe njerëzit përpiqen të hedhin mbeturinat në vendin e duhur duke bërë që unë të ndihem krenar për qytetin tim.”